
RAPORT VLERËSIMI

PRONA:

Pasuria nr. 245/22, në adresën:
Dushk, Lushnje.

PËR LLOGARI TË:

Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane

PRONARI:

Volalba shpk

PËRGATITI:

Ing. Spartan Kashuta
Nr. NIPT: L01801018V
Nr. Liç: Vp. 0448/1
Ing. Gjergji Kotori
Nr. Liç: Vp. 0106/1

Tiranë, me datë 26/05/2016

PËRMBAJTJA

HYRJE:	2
SEKSIONI Nr.1	3
1.1 ADRESA E PRONËS	3
1.2 DATA E VLERËSIMIT	3
1.3 PËRSHKRIMI I VENDNDODHJES DHE TË DHËNA EKONOMIKE.....	4
1.4 PËRSHKRIMI I PRONËS SI DHE FOTOT PËRKATËSE	5
1.5 ZOTËRIMI I PRONËS (PRONËSIA)	6
1.6 SIPËRFAQET	7
1.7 INFRASTRUKTURA, URBANISTIKA DHE RRUGËT	7
1.8 KUSHTET	7
SEKSIONI Nr.2	8
2.1 GJËNDJA E TREGUT	8
2.2 VLERËSIMI.....	8
2.3 REZERVIME	10
Materiali i bashkangjitur (lidhjet)	

LIDHJA NR. 1 - Dokumentacioni ligjore

PËR LLOGARI TË: Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane

PËRGATITUR NGA: Ing. Spartan Kashuta & Ing. Gjergji Kotori
Ekspert Vlerësues të Pasurive të Paluajtshme

PRONA: Pasuria nr. 245/22, në adresën: Dushk, Lushnje.

HYRJE:

Ky vlerësim është kryer sipas përcaktimeve të bera në Kontrate Shërbimi date 03.05.2016 dhe vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqesore Tirane date 03.05.2016.

Eksperiencia në fushën e vlerësimeve është kryesisht në Prona të Patundëshme të karakterit rezidencial, tregtar, industrial etj si dhe makineri e linja teknologjike.

Duke patur parasysh që Toka dhe Ndërtimet përfaqësojnë vlerat më të mëdha të pasurive të një vendi, punën time e kam mbështetur në zbatimin e standarteve profesionale, ndershmërisë dhe besueshmërisë me klientin për të cilin punojmë.

Vlerësimi realizohet sipas parimeve të përgjithshme të vlerësimit që aplikohen edhe në vendet europiane, në përputhje me Manualin e Standarteve Europiane të Vlerësimit.


Raporti, si i tërë, pjesë, apo referencë, nuk mund të përfshihet në asnjë dokument të shkruar, qarkore apo deklaratë dhe as nuk mund të publikohet në asnjë mënyrë pa miratimin tonë me shkrim për formën dhe kontekstin, në të cilin mund të përdoret.

SEKSIONI Nr.1

PRONA: Pasuria nr. 245/22 në adresën: Dushk, Lushnje.

PRONARI: Volalba shpk

1.1 ADRESA E PRONËS



Prona objekt vleresimi ndodhet ne perendim te fshatit Dushk, Lushnje, rreth 2 km ne perendim te autostrades Kavaje-Lushnje. Ne distance rreth 2 km ne jug perenim te prones ndodhet fhati Tre Urat. Zona ne te cilen ndodhet prona karakterizohet nga toka bujqesore.

1.2 DATA E VLERËSIMIT

Prona është inspektuar më datë 24/05/2016 dhe raporti i vlerësimit është përgatitur më datë 26/05/2016.

Zonimi i pronës**1.3 PËRSHKRIMI I VENDNDODHJES DHE TË DHËNA EKONOMIKE**

Prona ndodhet në fashtin Dushk, i cili pozicionohet në veri të qytetit të Lushnjës, rrethi Lushnje të qarkut Fier. Lushnja është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë së mesme, i cili është i vendosur në jug të Tiranës 80 km, në veriperëndim të Beratit rreth 45 km dhe në verilindje të Fierit rreth 35 km, në aksin e rrugës që lidh pjesën qendrore me zonën jugore të vendit, e cila tashmë është bërë autostradë. Ajo është qendra kryesore administrative, ekonomike, shoqërore, politike, turistike, kulturore e fetare e Rrethit të Lushnjës. Ka një popullsi rreth 30 000 banorë, me prespektivë të shtimit në vazhdimësi të këtij numri për shkak të ardhjes së shumë familjeve nga zonat përreth tij. Ky qytet ka një zhvillim mesatar ekonomik, ku rolin kryesor e zënë firmat e përpunimit dhe prodhimit të produkteve bujqësore-blektorale të fushës së Myzeqesë.

Fieri është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë, i cili është i vendosur në kryqëzimin e rrugëve që shkojnë në drejtimin e Gjirokastrës, Vlorës dhe Beratit. Ai është qendra kryesore administrative, ekonomike, shoqërore, politike, turistike, kulturore e fetare e rrethit të Fierit dhe prefekturës me qendër në të. Fieri ndodhet rreth 115 km në jug të Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Gjithashtu, ndodhet rreth 40 km larg Vlorës dhe rreth 40 km larg Beratit. Është një nga nyjet kryesore të jugut përse i përket transportit. Fieri është pjesë e rrjetit hekurudhor shqiptar.

1.4 PËRSHKRIMI I PRONËS SI DHE FOTOT PËRKATËSE

Inspektimi i jashtëm

Prona objekt vlerësimi siç e thamë dhe më lart është pasuria nr. 245/22 e cila konsiston një truall me sip. të hipotekuar prej 1000 m², nga të cilat 70 m² janë ndërtesë 1 katëshe (stacioni i pompave). Trualli ka një konfigurim të rregullt katërkëndorë, sipas skicave të paraqitura grafikisht më poshtë. Trualli shtrihet në një terren fushorë, është i niveluar dhe i rrethuar me shtylla betoni dhe tel metalik si dhe me mure tulle. Hyrja në pronë realizohet në anën perëndimore. Rruga e afrimit në pronë është rrugë rurale. Në pjesën qendrore të truallit pozicionohet ndërtesa 1 katëshe me sip. të hipotekuar prej 70 m²(stacioni i pompave). Nga ana konstruktive kjo ndërtesë është realizuar me themele të vazhduara, mure perimetrale dhe mbajtëse tulle, mbuluar me soletë të hidroizoluara. Nga jashtë, ndërtesa është e suvatuar dhe e bojatisur por shfaqet me rifinitura të thjeshta. Inspektimi i brendshëm nuk u realizua pasi ishte e mbyllur me dyer dhe dritare hekuri.

Nga informacioni I marë në terren, gjatë inspektimit, pronë shfrytëzohet nga njësia administrative përkatëse për nevojat e zonës. Gjithashtu mbi truall konstatohet një kabine elektrike si dhe struktura betoni në shërbim të tubacioneve.

Pozicionimi dhe identifikimi i pronës u realizua nga inspektimi në terren si dhe nga ballafaqimi i hartës treguese dhe kadastrale me foton satelitore të zonës. Theksoj se pozicionimi i saj është bërë me qëllim arritjen e vlerës së saj dhe nuk ka për qëllim përcaktimin e kufinjëve në terren apo të ndonjë qëllimi tjetër jashtë këtij raporti.



Pamje të pronës



1.5 ZOTËRIMI I PRONËS (PRONËSIA)

Për efekt të këtij vlerësimi është supozuar se Prona është e lirë nga çdo detyrim ligjor dhe pronësia është e pastër: a) - Rezultatet e kërkimeve në hipotekë dhe në organet shtetërore nuk prekin pronën dhe vlerën e saj. Kushtet për përdorimin e tanishëm e të ardhshëm të saj, janë të ligjshme; b) - Mos inspektimi i vendeve të veçanta, nuk sjell asnjë ndryshim në vlerësim.

Vertetim Hipotekor lëshuar nga Z.V.R.P.P Lushnje në të cilën vertetohet se në regjistrin hipotekor nr. 208, datë 05.10.2000, figuron e regjistruar në pronësi të Volalba shpk pasuria nr. 245/22, zk. 1582, me sip. 1000 m², në adresën: Dushk, Lushnje. Truall me sip. 1000 m², ndertese me sip. 70 m², stacioni i pompave.

1.6 SIPËRFAQET

Për të nxjerrë sipërfaqen e pronës u realizua inspektimi në pronë, u bë matja grafike e konturit të pasurisë në hartën treguese duke konkluduar se përputhen.

Në bazë të dokumentit të pronësisë:

	Truall, ka sip.	▶	1000 m ²
	Ndertese, ka sip.	▶	70 m ²

1.7 INFRASTRUKTURA, URBANISTIKA DHE RRUGËT

Nga një inspektim sipërfaqësor duket se prona është pjesërisht e pajisur me infrastrukturën e nevojshme. Furnizimi me energji elektrike është i mundur të realizohet nga rrjeti qendror i zonës. Furnizimi me ujë të mund të realizohet me anë të pusit gjeologjik. Nuk kemi bërë investime për këto supozim dhe as për përshtatshmërinë, kushtet e këtyre shërbimeve dhe për pasojë nuk mund të komentojmë më shumë. Është supozuar se përdorimi aktual i pronës mund të jetë i pakufizuar dhe se nuk ka kufizime staturore që mund të dëmtonin përdorimin dhe shitshmërinë e pronës. Në momentin e investigimit nga ana jonë, rruga e afrimit në pronë është rrugë dytësore e asfaltuar dhe në gjendje të mirë.

1.8 KUSHTET

Nuk kemi kryer një mbikqyrje strukturale të pronës dhe komentet tona kufizohen vetëm në ato të një inspektimi sipërfaqësor që mund të bënim mbi pronën. Duhet nënvizuar se prona është inspektuar vetëm nga niveli sipërfaqësor.

SEKSIONI Nr.2

2.1 GJËNDJA E TREGUT

Nga investigimi në terren rezulton se në këtë zone transaksionet për prona të ngjashme (toka bujqësore apo troje) janë të pakta si rezultat i mungësës së kërkesë-orfertës, e diktuar kjo nga pozicionimi gjeografik, zhvillimi ekonomik i zonës, si dhe tipologjia e pronës etj.

Eshte nje zone e mirfilltë rurale, me karakter bujqësore, e cila sa shkon dhe bëhet me e kërkuar, referuar gjithmonë aktivitetit bujqësor.

Vihet re zhvillimi i serave, por dhe kërkesa për sip. të konsiderueshme tokash bujqësore, mbi 50 ha, kundrejt shitjes apo dhe dhënies me qera për afate të caktuara kohore.

Shit-blerje trojesh, nuk evidentohen, por vetem toka bujqësore.

Nga informacioni I marë në zonën përreth, në lidhje me vlerat e transkacioneve më të fundit në zonë, paraqitet një situatë si më poshtë:

Toka bujqësore me sip të konsiderueshme 300 lek/m² deri në 5'00 lek/m², ndërsa për sip. Relativisht me të vogla (7'000 m²) vlerat kanë diapazone të tjera, 600 -1'000 lek/m².

në varësi të sip. së disponueshme, pozicionit gjeografik, etj.

Sipas: VENDIM Nr. 89, datë 3.2.2016 PËR MIRATIMIN E HARTËS SË VLERËS SË TOKËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, si dhe mbi bazën e kostos së ndërtimit të objektit të vëllimeve në gjëndjen aktuale.

RRETHI	Fshati	ZONA KADASTRALE	VLERA E PASURISE TRUALL LEKË/(m ²)
Lushnje	Dushk	1582	503

2.2 VLERËSIMI

Vlera e Tregut të Lirë të kësaj prone është llogaritur në bazë të informacioneve të marra në tregun e shit-blerjeve si dhe supozimeve të bëra gjatë këtij raporti. Në përcaktimin e vlerës është marrë parasysh gjëndja dhe niveli i tregut në zonën përreth pronës, gjëndja fizike e pronës, vendodhja e saj, kushtet në të cilat ndodhet, mundësitë e shfrytëzimit të saj, etj.

Opinionin tonë për vlerën e kapitalit të pronës e kemi formuar në bazë të vlerave të shitjeve të pronave në zonën përreth, duke përdorur Metoden e Krahasimit të Drejtëpërdrejtë (The Sales Comparison Approach) (referuar dhe cmimeve të referencës) Metoden e Kostos Zëvendësuese të Amortizuar (The Cost Approach) korektuar me koeficientët përkatës.

Në rastin konkret kemi të bëjmë ligjërisht me një truall me sip. 1000 m² dhe ndërtesë, (stacion pompimi) sipas përshkrimit. Ky stacion është në funksion të fabrikës së tullave, por jo vetëm. Distanca nga fabrika e deri tek stacioni i pompave, është 6.5 km në vijë ajrore. Siapas gjykimit tonë, në lidhje me përdorimin me të mirë të mundshëm, mund të them se përvec destinacionit aktual, kjo pronë mund ti shërbente fare mirë dhe komunitetit përreth, në lidhje me furnizim me ujë për të mbjellat. Ky fakt ndikon pozitivisht në vlerën e pronës.

RAPORT VLERËSIMI

Faktorë negativ, ne këtë rast kemi amortizimin fizik. Në këtë vlerësim janë marrë në konsideratë dhe tërë faktorët fizik, të përmendur në përshkrimin e pronës ashtu dhe faktorët gjeografik, makroekonomik, me ndikim indirekt në vlerën e pronës.

Vlerësimi është bërë me supozimin e shitjes së pronës sipas destinacionit aktual dhe duke vlerësuar dhe gjëndjen e tregun e pasurive të paluajtëshme në shkallë më të gjërë.

Nisur nga sa me lart, për truallin, kam adoptuar një çmim prej **1400 lek/m²**, për situatën faktike ne te cilen ai ndodhet, duke përfshirë dhe investimet në infrastrukturë.

Në vlerën e pronës nuk është marrë në konsideratë vlera e aseteve mekanike (pompa, linja e tubacione).

Ne lidhje me vlerën e ndërtesat kam marrë për baze një kosto të mesatarizuar duke u mbështetur në karakteristikat e saj si dhe në amortizimin e përgjithshëm që shfaqet sipas tabelës së më poshtme.

VLERA E TREGUT TE LIRE										
nr.	Vlera e koston bruto së zhvillimit				Norma e amortizimit			Vlera përfundimtare		
	Lloji i pronës	sip. (m2)	Vl. Kos. Fillest		Fizik %	Funks + ext. %	Total %	për njësi	totale	
		Lek/m2	Lek							
1	Ndërtesë një katëshe (banim)									
	Nd. 1 kat, st. pompa	70	19,375	1,356,250	31%	0.0%	31%	13,369	935,813	
	Vlera e objektit sipas metodës së koston është							Lek	13,369	935,813
	Truall me nr. pasurie 245/22									
	Lloji i pronës	sip. (m2)	Vlera							
			Lek/m2	Lek						
	Truall	1,000	1,400	1,400,000						
	Vlera totale e Tregut të Lirë të pronës me nr. pasurie 245/22, bazuar në: metodën e Koston së Zëvendësimit (nd.) dhe atë të Krahasimit të Drejtpërdrejtë (tr.)							Lek	2,335,813	
								€uro	16,878	
	(Vlera e këmbimit të euros në datën e vlerësimit 26.05.2016, referuar kursit zyrtar të këmbimit)							1	138.39	
							€uro	Lek		

Vlera e Tregut sipas Komitetit Ndërkombëtar të Standarteve të Vlerësimit përkufizohet:

"Vlera e tregut është Shuma e vlerësuar, për të cilën një pronë shkëmbehet në datën e vlerësimit midis një shitësi të vullnetshëm dhe një blerësi të vullnetshëm, në një transaksion, ku palët nuk kanë lidhje me njëra tjetrën, pasi të jetë bërë marketingu i duhur, ku palët kanë vepruar me dijeni me kujdes dhe pa detyrim".

Vlera e Tregut të Lirë të Pronës:

	Total	Monedha
Vlera e pronës, me nr. pasurie 245/22, është	▶ 2335813	ALL
	▶ 16878	€uro

(Vlera e këmbimit të euros në datën e vlerësimit 26/05/2016, referuar kursit zyrtar të këmbimit, është 1 Euro = 138.39 lekë)

Theksojmë se kjo shifër është subjektive dhe nuk merr parasysh ndryshimin e faktorëve politikë dhe makroekonomikë në vend, ndaj të cilëve tregu i pronave është tepër i ndjeshëm. Meqënëse në Shqipëri stabiliteti makroekonomik tronditet lehtë (tronditet shpesh edhe për shkak të ndryshimeve të lehta politike), mendoj se është e vështirë të parashikohet në mënyrë optimale gjendja e këtij tregu në të ardhmen.

2.3 REZERVIME

- Nuk kemi inspektuar pjesë të strukturës që janë të mbuluara, të paeksponuara apo të paarrtëshme. Për pasojë s’jemi në gjendje të raportojmë mbi mungesën e rrezikshmërisë së kësaj prone. Të gjitha inspektimet janë bërë vetëm nga niveli përdhës.
- Gjithashtu është supozuar se kjo pronë është e lirë nga çdo barrë, kufizim pronësie, apo pretendim të palëve të tjera.
- Në vlerësim nuk është marrë parasysh asnjë qeradhënie apo marrëveshje e mundëshme. Kemi supozuar se nuk ka asnjë problem me përdoruesit e tanishëm të pronës dhe se nuk ka asnjë problem ligjor në lidhje me këtë çështje. *Megjithatë kjo çështje mendoj se duhet t’i kalojë për shqyrtim këshilltarit Tuaj ligjor.*
- Vlerësimi i pronës është bërë duke gjykuar mbi ecurinë e tregut, dy vjecarin e fundit. Ai nuk parashikon ndryshimet në përgjithësi të tregut në të ardhmen, si dhe ndryshimet që mund të pësojnë parametra të veçantë të pronës apo të zonës ku ndodhet prona, objekt i këtij vlerësimi.
- Kemi supozuar për qëllim të këtij vlerësimi, se:
 - a) nuk ekzistojnë ndotje (ose kostoja e punës për pastrimet do të jetë e papërfillëshme në vlerësim)
 - b) Nuk supozohet asnjë përgjegjësi për ekzistencën e ndonjë ndotjeje, as për ndonjë ekspertizë apo kërkim shkencor të kërkuar për ta zbuluar atë.
 - c) Nëse si rrjedhojë përcaktohet se ekziston ndotje në pronën subjekt ose në pronat fqinje, ose nëse pronat kanë pasur ose kanë një përdorim që mund të ndotë, kjo mund të reduktojë vlerën e raportuar.

PËRGATITI:

Ing. Spartan Kashuta
Nr. NIPT: L01801018V
Nr. Liç: Vp. 0448/1
Ing. Gjergji Kotori
Nr. Liç: Vp. 0106/1

LIDHJA NR.1 DOKUMENTAT LIGJORE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 ZYRA REGJISTRIMIT TE PASURIVE TERRESTRIALE SHQIPERISE
 RRETHI LUSHNJE DHOMA NOTEREVE LUSHNJE
 NR. 1679 DT. 27. 10. 2000
 VERETIMET FOTOKOPJA ME
 ORIGINALIN, NOTER: L. G. I. A.

VERETIM
 NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. 208 të datës 05.10.2000, figuron e regjistruar në pronësi të:



Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa
<u>Chaku</u>	<u>io</u>	<u>dukektor me shqiperine</u>	
<u>Voligba</u>	<u>Shqiperia</u>	<u>Albanonora s.r.l</u>	

Pasuria me numër 245/22 e ndodhur në Zonën Kadastrale 15B2 me sipërfaqe 1000 m², në adresën sat. Dushk, Dushk
e Ujirit (stacion i pompave) me sipërfaqe 70 m²

Kufizimet e pasurisë janë:
 V 245/11/24 L 245/24
 J 452 P 245/20

Origjina e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme:
 nr. hip. - datë: -/- nr. hip. - datë: -/-
 nr. hip. - datë: -/- nr. hip. - datë: -/-
 nr. hip. - datë: -/- nr. hip. - datë: -/-

Barrë nipi pasurinë: mut kg

Komente nga Regjistruesi: Konvertimi i kufizimit të pronësive të
shpirtërore N. 27.06.2000

Ky vërtetim është i vlefshëm i shoqëruar me Hartë Treguese Provizore

Zyra e Regjistrimit nuk garanton vërtetimin e pronësisë përpara përfundimit të Regjistrimit Fillestar sipas Ligjit Nr. 7843, datë 13/07/1994

Vërtetimi i pronësisë lëshohet sipas kërkesës Nr. 1342
 Datë 4.10.2000 paraqitur në ZRPP

NEPUNESI I SEK. URBAN
 Erleta SOTA
 Datë: 05.10.2000

REGJISTRUESI
 Aziti HOXHA

LUSHNJE



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT


ZYRA E REGJISTRIMIT TE
PASURIVE TE PALUAJTESHME
LUSHNJE



A- IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 1582
NR. PASURIS 245/22.V F
INDEKSI I HARTES K.34-112-13-B
SHKALLA 1:1000
ADRESA E PASURISE:
RRETHI LUSHNJE Dushk i Madh
Rr/L _____ PIC _____
Sh _____ K _____ Ap _____

PRONARI



KUFIZIMET

- V- 245/1; 245/2.
- L- 245/24.
- J- 452.
- P- 245/20.

HARTOGRAFI

ng. A. KOJKU

(Handwritten signature)

Data 1/1 vit ---



REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
SEKSIONI TREGTAR

Gjykata e Falimentimit

Nr. Akti 1693

Datë rregjistrimi 22 prill 2016

Datë vendimi 03 maj 2016

V E N D I M

"Mbi zëvendësimin e grupit të ekspertëve mekanik dhe vlerësues"

Gjykata e Falimentimit me trup gjykues të përbërë nga:

Rezarta MATAJ ----- Gjyqtare

Në dhomë këshillimi, sot më datë 03 maj 2016 ora 15:35 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen e falimentimit që i përket :

Kërkes: Adminsitatore e falimentimi Shpresa Breçani, e Shoqërisë Volalba shpk në falimentim.

Me objekt : Zëvendësimin e ekspertëve Petrika Naço dhe Agim Kika për mos rinovim liçense etj. bazuar në ligjin nr. 8901 datë 23/05/2002 "Për falimentimin " i ndryshuar.

Gjykata pasi u njoh me kërkesën e adminsitatores së falimentimit dhe verifikoi këreksat e vetë ekspertëve Petrika Naço dhe Agim Kika për zëvendësim, konsultoi çështjen në ligj, prova dhe bindjen e saj të brëndshme

V E R Ë N S E

1. Shoqëria në falimentim "Volalba" sh.a ka hapur procedurat e falimentimit me vendimin datë 08 maj 2013 me nr. 5059 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (GJRRGJ Tiranë).Administratore e falimentimit është Znj. Shpresa Breçani.

2. Rezulton se me vendimin e datës 06 prill 2016 të GJRRGJ Tiranë, Gjykatë Falimentimi u vendos që të vlerësohej masa e falimentimit të Shoqërisë Volalba shpk duke u caktuar dy ekspert me njohuri si vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe të diplomuar në inxhinieri mekanike meqëse masa e falimentimit përbëhet nga linja prodhimi të tullave, makineri etj. por edhe pasuri të paluajtshme etj.

Faqe 1 nga 4

3. Nga lista e ekspertëve vlerësues të pasurive të paluajtshme të referuar nga Shoqata e tyre opër vitin 2016 u caktua me emër nominal Petrika Naço dhe Agim Kika. (shih kërkesat në dosje).

4. Të dy këto ekspert me datë 28 prill 2016, të paraqitur personalisht i bënë me dije gjykatës që nuk e pranojnë detyrën për shkak të gjëndjes shëndtësore (Z.Kika dhe Z.Naço) dhe për shkak të mosrinovimit të liçensës së tyre (z. Naço). (shih më tej kërkesat para gjykatës me shkrim)

5. Për këtë arsye gjykata vendosi të kontaktoj me email dhe me numër telefoni të gjithë ekspertët e tjerë që janë të gatshëm: Altin Behluli, Mirela Behluli, Anton Lezhja, Spartan Kashuta, Gjergj Kotori dhe Kostaq Andoni nga ku rezultoi se: Altin Behluli, Mirela Kashuta, Anton Lezhja nuk dhanë vullnetin për të marë përsipër detyrën për shkak të volumit në punën e tyre, Kostaq Andoni në telefon dhe në emailin e tij dhe në adresë nuk rezulton efektive ndërsa Spartan Kashuta dhe Gjergj Kotori u paraqitën në gjykatë, u identifikuar dhe pranuan të caktohen. (shih emaillet në dosje)

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar ligjin nr. 8901/2002 "Për falimentimin" e ndryshuar, neni 119 si dhe Standardet Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentimit

VENDOSI

1. Të pranoj kërkesë e administratorës së falimentimit të Shoqërisë Volalba shpk për caktimin e ekspertëve për të vlerësuar vlerën aktuale të masës së falimentimit të shoqërisë.
2. Të caktoj në përbërje të grupit të ekspertëve vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe me njohuri mekanike **ing. Spartan Kashuta** dhe **Ing. Gjergji Kotori**.
3. Një kopje e këtij vendimi u dërgohet ekspertëve dhe administratorës që të mos pengohen në ushtrimin e detyrës së tyre.
4. Paraqitja nga administratorja e aktit të vlerësimit të hartuar nga ekspertët të bëhet deri me datë **03 qershor 2016 ora 15:100** në Gjykatë.
5. Vlerësimi të bëhet duke bërë këqyrjen në vend dhe me tërë aktet që ndodhen në dosje apo ato që disponon administratorja e falimentimit.
6. Për çdo realizim më të shpejtë të këtij akti të vihet në dijeni kryesuesja nëpërmjet Adminsitratores së shoqërisë Volalba shpk.
7. Mbulimi i shpenzimeve të ekspertëve të realizohet nga adminsitratorkja duke iu dhënë autorizimi përkatës për të këtë veprim.
8. Një kopje e këtij vendimi afishohet publikisht në eëbsitin e GJRRGJ Tiranë dhe të ABSA Tiranë për tu njohur palët e tjera në gjykim.

U shpall në Tiranë sot më 03 maj 2016 !

Gjyqtare

Rezarta MATAJ

Faqe 3 nga 4